

VENDIM

PËR REGJISTRIMIN E PERSONIT JURIDIK

Sot më datë 23.03 2007, une M. Vllas, Gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane, pasi mora në shqyrtim kërkesën dhe materialin e paraqitur nga kërkuesi Z. Arben Naun Petto, ne cilësinë e Administratorit të vetëm të shoqërisë, për regjistrimin e shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "ISPP" Sh.p.k ,

K O N S T A T O V A:

Se kërkuesi Z. Arben Petto, në cilësinë e Administratorit të vetëm të shoqërisë, ka paraqitur kërkesën për regjistrimin si Person Juridik të shoqërisë "ISPP" Sh.p.k", në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar.

Ortaku i vetëm është Z. Arben Petto, person me shtetësi shqiptare, i datelindjes 21/2/1960, me adresë banimi Rruga "Abdyl Frasheri", Tirane, Shqipëri. Mbajtes i Pasaportës me Nr Z 0116878, person me zotësi të plote juridike për të vepruar

Emertimi i plote i shoqërisë është "Instituti i Studimeve dhe Projektimeve Pyjore".

Emertimi i shkurtuar është "ISPP" Sh.p.k.

Selia e Shoqërisë "ISPP" Sh.p.k. është në adresën: Rruga "Myslym Shyri", Pallati 6, Ap 35, Tirane, Shqipëri.

Administratori i vetëm është Z. Arben Petto, person me shtetësi shqiptare, i datelindjes 21/2/1960, me adresë banimi Rruga "Abdyl Frasheri", Tirane, Shqipëri. Mbajtes i Pasaportës me Nr Z 0116878.

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë për një periudhë të pacaktuar kohore.

Kapitali themeltar i shoqërisë "Instituti i Studimeve dhe Projektimeve Pyjore" Sh.p.k është 100 000 (njëqind mijë) Leke, i ndarë në 100 pjesë me vlerë nominale prej 1.000 (një mijë) leke secila.

Shoqëria "Instituti i Studimeve dhe Projektimeve Pyjore" Sh.p.k do të ketë për objekt :

Ne fushën e Studimeve dhe projektive të pyjeve objekti do të jetë:

- për hartimin e planeve të menaxhimit të pyjeve, flores spontane, gjuetise sportive e turistike dhe kullotave.
- për hartimin e projekteve të pyllëzimit
- për hartimin e projekteve të shfrytëzimit të qëndrueshëm të pyjeve
- për hartimin e projekteve të menaxhimit të pëllgjeve ujëmbledhës

Ortaku i vetem eshte Z. Arben Petto, person me shtetesi shqiptare, i datelindjes 21/2/1960, me adrese banimi Rruga "Abdyl Frasherit", Tirane, Shqiperi. Mbajtes i Pasaportes me Nr Z 0116878.

Emertimi i plote i shoqerise eshte "Instituti i Studimeve dhe Projektimeve Pyjore".

Emertimi i shkurtuar eshte "ISPP" Sh.p.k.

Selia e Shoqerise "ISPP" Sh.p.k.është ne adresen: Rruga "Myslym Shyri", Pallati 6, Ap 35, Tirane, Shqiperi.

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine per nje periudhe te pacaktuar kohore.

Kapitali themeltar i shoqerise "Instituti i Studimeve dhe Projektimeve Pyjore" Sh.p.k eshte 100 000 (njqind mije) Leke, i ndare ne 100 pjese me vlere nominale prej 1.000 (nje mije) leke secila.

Shoqeria do te administrohet nga nje Administrator i Vetem.

Administratori eshte Z. Arben Petto, person me shtetesi shqiptare, i datelindjes 21/2/1960, me adrese banimi Rruga "Abdyl Frasherit", Tirane, Shqiperi. Mbajtes i Pasaportes me Nr Z 0116878.

Shoqeria "Instituti i Studimeve dhe Projektimeve Pyjore" Sh.p.k do të ketë për objekt :

Ne fushen e Studimeve dhe projektive te pyjeve objekti do te jete:

- për hartimin e planeve te menaxhimit te pyjeve, flores spontane, gjuetise sportive e turistike dhe kullotave.
- për hartimin e projekteve të pyllëzimit
- për hartimin e projekteve të shfrytëzimit të qëndrueshëm të pyjeve
- për hartimin e projekteve të menaxhimit të pëllgjeve ujëmbledhës
- për studimin e menaxhimit e përdorimit të territorit

Ne fushen e zbatimit te punimeve pyjore objekti do te jete ;

- për pyllëzimet(fidanishtet, grumbullimin e trajtimin e farerave, punimet pergatitore e mbjellje fidanësh)
- për përmirësimin e pyjeve(ricungim e trajtim pyjesh me prerje kulturore)
- për shfrytëzimin e qëndrueshëm të pyjeve
- për sistemimet malore.
- për ndërtimin e rrugëve pyjore.
- për punimet në kullota, livadhe dhe ndërtimin e merementimin e veprave për sigurimin e ujit të pijshëm në kullota e livadhe.

Ne fushen e ndertimeve, ne zbatim objekti do te jete:


- Gërmime dheu me punime eventuale murature e betonarme – prishje dhe punime në tokë të gërmuar.
- Prodhim materiale inerte –gurë.
- Prodhim elemente betoni e betonarme të zakonshëm – 2. paranderur – 3. gurë dekorativë – mermer.

- Ndërtime civile – industriale – turistike – bujqësore deri në 5 kate.
- Ndërtime civile – industriale – turistike – bujqësore mbi 5 kate – Rikonstruksione.
- Ndërtim banese me skelet mbi 8 kate.
- Ndërtim rruge kategoria IV dhe V.
- Ndërtim rruge kategoria III dhe II.
- Punime të mirëmbajtjes dhe sinjalizimit në rrugë, ndërtim mbishtresa rrugore.
- Ndërtim ura dhe vepra arti deri në 10 m.
- Ndërtime portuale – bankina – basene - pontile.
- Ndërtim ujësjellës – kanalizime –kanale e impiante vaditjeje.
- Ndërtim diga – damba deri 10 m.
- Sillose, kulla, kulla uji etj., prej betonarme- metalike.
- Përforcime themeli e punime nëntokësore.
- Izolime mbi dhe nëntokësore nga ujërat.
- Themele të veçanta.
- Punime karpentjerie druri.
- Punime karpentjerie metali.
- Instalim i impianteve higjenike, kuzhina, lavanteri, hidrosanitare- mirembajtja e tyre
- Instalim i materialeve prej druri-metalike plastike-xhami.
- Punime bojatisje – hidroizolimi – termoizolimi – akustikë – kundra zjarrit.

Urdherohet Zyra e Regjistrimit Tregtar te kryeje veprimet perkatese ne Regjistrin Tregtar.

Kunder ketij vendimi mund te behet ankim ne Gjykatën e Apelit.

Tirane, me 23-03 2007

GJYQTARI


STATUTI I SHOQERISE

"Instituti i Studimeve dhe Projektimeve Pyjore" Sh.p.k
ISPP Sh.p.k.



I.Dispozita te Pergjithshme

NENI 1

Emertimi dhe Forma e Shoqërisë

1.1 **"ISPP" Sh.p.k** themelohet në formën e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar dhe aktiviteti i kesaj shoqerie do te rregullohet nga ky Statut dhe nga ligji nr. 7638, date 19.11.1992, "Per shoqerite tregtare".

1.2. Emërtimi **"ISPP" Sh.p.k** dhe emri i administratorit do të figurojnë në të gjitha aktet ose dokumentet e nxjerra nga shoqëria dhe që u drejtohen të tretëve.

1.3. Shoqeria **"ISPP" Sh.p.k** e fiton personalitetin e saj juridik nga dita e regjistrimit te saj ne Gjykate.

NENI 2

Dokumentat Rregullues

2.1. Dokumenti kryesor mbi të cilin bazohet aktiviteti i Shoqërisë **"ISPP" Sh.p.k** është Statuti i saj. Me ane te ketij Statuti dhe ne perputhje me Aktin e Themelimit dhe me legjislacionin shqiptar, rregullohet pozita juridike e Ortakut te vetem dhe punonjesve te Shoqerise, organizimi dhe objekti i veprimtarise se Shoqerise dhe çeshtjet e tjera me rëndësi për aktivitetin e saj.

2.2 Per çështjet qe nuk zgjidhen nga Statuti, Ortaku vetem me vendim te tij mund të miratojë një Rregullore të Veçantë.

2.3. Statuti dhe Rregullorja e Veçantë janë dokumenta të hapura për ndryshime dhe përmirësime që zhvillimet i bëjnë të nevojshme.

NENI 3

Ortaku

3.1 Ortaku i vetem i **"ISPP" Sh.p.k** eshte Z. Arben Petto, person me shtetesi shqiptare, i datelindjes 21/2/1960, me adrese banimi Rruga "Abdyl Frasherit", Tirane, Shqiperi. Mbjetes i Pasaportes me Nr Z 0116878.

NENI 4

Selia

4.1. Shoqeria **"ISPP" Sh.p.k** e ka seline e saj ne adresen: Rruga" Myslym Shyri" Pall 6, ap 35, Tirane, Shqiperi.

Shoqeria vepron si person juridik shqiptar dhe si e tillë mund te kryeje aktivitetin e saj ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise ose jashte saj, nepermjet filialeve, degeve, zyrave

te perfaqesimit ose agjensite e saj, te cilat jane krijuar me vendim të Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë dhe do te veprojnë nen mbikqyrjen e Administratorit të "ISPP" Sh.p.k.

4.2.Administratori mund të transferojë Selinë e Shoqërisë brenda teritorit te Shqipërisë.

NENI 5 Vula, Stema

5.1. Shoqëria "ISPP" Sh.p.k ka vulen e saj mbi te cilen ka te shkruar emertimin e saj.

5.2. Stema e "ISPP" Sh.p.k duhet te figuroje ne te gjithe materialet prezantuese dhe shkresat zyrtare të Shoqërisë.

NENI 6 Kohezgjatja

6.1. Shoqëria do te kryejë aktivitetin e saj per nje periudhe kohe te pacaktuar pervec kur vendoset ndryshe nga Ortaku i saj.

NENI 7 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë

7.1. Shoqëria "ISPP" Sh.p.k ushtron veprimtarinë e saj me qëllim realizimin e fitimit, duke u mbështetur në parimet e likuiditetit, sigurisë dhe rentabilitetit, sipas rregullave të parashikuara nga legjislati shqiptar.

7.2. Veprimtaria e Shoqërisë "ISPP" Sh.p.k, do të ketë për objekt;

Ne fushen e Studimeve dhe projektive pyjeve objekti do te jete:

- për hartimin e planeve te menaxhimit te pyjeve, flores spontane, gjuetise sportive e turistike dhe kullotave.
- për hartimin e projekteve të pyllëzimit
- për hartimin e projekteve të shfrytëzimit të qëndrueshëm të pyjeve
- për hartimin e projekteve të menaxhimit të pellgjeve ujëmbledhës
- për studimin e menaxhimit e përdorimit të territorit

Ne fushen e zbatimit te punimeve pyjore objekti do te jete ;

- për pyllëzimet(fidanishtet, grumbullimin e trajtimin e farerave, punimet pergatitore e mbjellje fidanësh)
- për përmirësimin e pyjeve(ricungim e trajtim pyjesh me prerje kulturore)
- për shfrytëzimin e qëndrueshëm të pyjeve
- për sistemimet malore.
- për ndërtimin e rrugëve pyjore.
- për punimet në kullota, livadhe dhe ndërtimin e merementimin e veprave për sigurimin e ujit të pijshëm në kullota e livadhe.

Ne fushen e ndertimeve, ne zbatim :

- Gërmime dheu me punime eventuale murature e betonarme - prishje dhe punime në tokë të gërmuar.



- Prodhim materiale inerte –gurë.
- Prodhim elemente betoni e betonarme të zakonshëm – 2. paranderur – 3. gurë dekorativë – mermer.
- Ndërtime civile – industriale – turistike – bujqësore deri në 5 kate.
- Ndërtime civile – industriale – turistike – bujqësore mbi 5 kate –Rikonstruksione.
- Ndërtim banese me skelet mbi 8 kate.
- Ndërtim rruge kategoria IV dhe V.
- Ndërtim rruge kategoria III dhe II.
- Punime të mirëmbajtjes dhe sinjalizimit në rrugë, ndërtim mbishtresa rrugore.
- Ndërtim ura dhe vepra arti deri në 10 m.
- Ndërtime portuale – bankina – basene - pontile.
- Ndërtim ujësjellës – kanalizime –kanale e impiante vaditjeje.
- Ndërtim diga – damba deri 10 m.
- Sillose, kulla, kulla uji etj., prej betonarme- metalike.
- Përforcime themeli e punime nëntokësore.
- Izolime mbi dhe nëntokësore nga ujërat.
- Themele të veçanta.
- Punime karpentjerie druri.
- Punime karpentjerie metali.
- Instalim i impianteve higjenike, kuzhina, lavanteri, hidrosanitare-mirembajtja e tyre
- Instalim i materialeve prej druri-metalike plastike-xhami.
- Punime bojatisje – hidroizolimi – termoizolimi – akustikë – kundra zjarrit.

7.3. Shoqëria "ISPP" Sh.p.k mund te kryeje cdo lloj veprimtarie tjetër që është në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe që siguron fitime dhe të ardhura të ligjshme brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, mund të kryejë cdo operacion prodhimi, tregtar dhe financiar, që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj. Kjo përfshin gjithashtu hapjen e veprimtarive dhe krijimin e shoqërive të tjera brenda dhe jashtë vendit.

7.4. Shoqëria, me vendim të Administratorit, dhe pas miratimit paraprak të Ortakut te vetem, mund të lidhë marrëveshje tregtare apo bashkëpunimi me shoqëri apo sipërmarrje të tjera, si dhe të kryejë cdo veprim tregtar që konsiderohet i nevojshëm me qëllim arritjen e objektit të veprimtarisë së saj.

7.5. Shoqëria mund të ndryshojë objektin e veprimtarisë së saj dhe emërtimin vetëm me Vendim te Ortakut te vetem. Vendimi i Ortakut te vetem administrohet në përputhje me legjislacionin dhe rregjistrohet në Zyrën e Rregjistrimit Tregtar dhe në Organet Tatimore.

7.6. Shoqëria "ISPP" Sh.p.k do te ushtroje veprimtarine per ato aktivitete qe kerkojne marrjen e licensave dhe lejeve perkatese vetem pas marrjes se tyre nga organet dhe strukturat e caktuara nga ligji. Shoqëria "ISPP" Sh.p.k do te ushtroje veprimtarine në përmbushje të objektit të veprimtarisë së saj, duke zbatuar të gjithë ligjet dhe aktet nënligjore rregullues në lidhje me liçensimin, kushtet, procedurat dhe afatet e kërkuar. Gjatë kohëzgjatjes së aktivitetit të saj Shoqëria "ISPP" Sh.p.k zbaton standartet më të larta të etikës profesionale dhe zbatimit të ligjshmërisë.

II. KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, PJESET E KAPITALIT THEMELTAR

NENI 8 Kapitali themeltar

- 8.1. Vlera e Kapitalit Themeltar të Shoqërisë "ISPP" Sh.p.k është 100.000 Leke.
- 8.2. Kapitali ndahet ne 100 pjese te barabarta, secila me vlere perj 1.000 leke, te nenshkruara dhe te shiyëra plotesisht nga Ortaku i vetem.
- 8.3. Kapitali depozitohet sipas nenit 40 te ligjit nr.7638, date 19.11.1992, "Per shoqerite tregtare".
- 8.4. Pjeset e Kapitalit Themeltar nuk materializohen ne letra me vlere te tregtueshme por vertetohen me ane te certifikatave nominative te leshuara nga shoqeria.

NENI 9 Transferimi

- 9.1. Ortaku i vetem mund te transferoje te gjitha ose pjeserisht pjeset e tij te kapitalit.
- 9.2. Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar, ne çdo rast, duhet te vertetohet me akt noterial.

NENI 10 Zmadhimi i Kapitalit

- 10.1. Kapitali themeltar mund te zmadhohet me vendim te ortakut, ne perputhje me nenet 62 dhe 63 te ligjit nr.7638, date, 19.11.1992, "Per shoqerite tregtare", ne baze te raportit te Administratorit te Shoqerise.
- 10.2. Zmadhimi i kapitalit mund te kryhet me ane te kontributeve te reja ne para, me ane te kontributeve ne natyre ose me perfshirjen e rezervave dhe fitimit si pjesë të Kapitalit Themeltar.
- 10.3. Ne rast zmadhimi te kapitalit me ane te kontributeve në para, te gjitha pjeset e reja të Kapitalit duhet te nenshkruhen dhe te shlyhen teresisht nga Ortaku. Ato duhet te depozitohen nga nenshkruesi në Bankë per llogari te Shoqerise "ISPP" Sh.p.k. Terheqja e fondeve te reja mund te behet vetem pas rregjistrimit te zmadhimit te kapitalit ne Rregjistrin Tregtar.

NENI 11 Zvogelimi

- 11.1. Zvogelimi i kapitalit deri ne nje vlere jo me te vogel se 100 000 leke mund te kryhet me vendim te ortakut, ne perputhje me nenin 64 te ligjit nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare".
- 11.2. Ne rast se kapitali i shoqerise, per shkak te humbjeve te konstatuara ne dokumentat financiare, rezulton me i vogel se gjysma e kapitalit themeltar, brenda kater muajve nga miratimi i llogarive qe pasqyrojne keto humbje, ortaku duhet te vendosi ose prishjen e shoqerise, ose zvogelimin e kapitalit me nje vlere me te madhe se ajo e humbjeve qe kane mbetur te pambuluara nga rezervat, por pa e zbritur kapitalin nen shumen 100 000 Leke, ne perputhje me nenet 72 dhe 38, Ligji nr. 7638, date. 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare".



III. MARRJA E VENDIMEVE , ADMINISTRIMI, DHE KONTROLLI I SHOQERISE

NENI 12

Ortaku duhet te shprehet me nje vendim personal per gjithcka eshte ne kompetence te asamblese sic jane miratimi i llogarive vjetore, caktimi i rezultatit, emerimi i administratorit, emerimi i ekspertit kontabel te autorizuar kur eshte rasti, zmadhimi ose zvogelimi i kapitallt, ndryshimi i objektit etj deri tek prishja e shoqerise.

Kompetencat e ortakut te vetem per vendimet qe I perkasin asamblese nuk mund ti delegohen askujt tjetër.

Ortaku i vetëm miraton llogaritë, nëse është e nevojshme pas raportit të ekspertëve kontabël të autorizuar, brenda 6 muajve nga mbyllja e vitit financiar.

Ortaku i vetëm mund t'i delegojë kompetencat e tij.

Vendimet e marra nga ortaku i vetem, duhet te shenohen dhe te firmosen ne nje regjister te posacem, i cili duhet te jete i miratuar dhe i vulosur si per te gjithë shoqerite e tjera.

Vendimet e marra në kundërshtim me përmbajtjen e këtij neni mund të anulohen me kërkesë të çdo personi të interesuar.

Te gjitha vendimet e shoqerise regjistrohen ne nje liber te veçante qe mbahet ne seline e Shoqerise, i cili duhet të jetë i numërtuar dhe i vulosur.

NENI 13

Administratori i Shoqërisë

13.1. Shoqeria administrohet nga Administratori, nje person fizik qe mund te jete ose jo ortak i Shoqerise.

13.2. Administratori është i detyruar të drejtojë Shoqërinë "ISPP" Sh.p.k. në përputhje me ligjin « Për Shoqëritë Tregtare », këtë Statut, vendimet e Ortakut te vetem dhe sipas dispozitave të tjera ligjore në fuqi.

13.3. Ne rastet kur Administratori është Ortak i Shoqërisë "ISPP" Sh.p.k. në baze te nenit 5 te Kodit Shqiptar te Punes, detyra e Administratorit nuk do të regullohet nga kontrata e punes.

NENI 14

Emërimi dhe shkarkimi i Administratorit

14.1. Administratori i Shoqerise emerohet dhe shkarkohet nga Ortaku i vetem, si dhe do te qendroje ne detyre per një kohë të pacaktuar.

14.2. Administratori i parë i Shoqërisë "ISPP" Sh.p.k emerohet me miratimin e Ortakut te vetem te percaktuar ne Aktin e Themelimit të Shoqërisë.

14.3. Kohëzgjatja e mandatit të Administratorit mund të përcaktohet nga Ortaku sa herë që bëhet emërimi i Administratorit dhe do të parashikohet në aktin e emërimit. Në mbarim të afatit të parashikuar, Administratori mund të riemërohet. Në mungesë të parashikimeve kohore në



aktin e emërimit, Administratori do të ushtrojë detyrat e tij për të gjithë periudhën e aktivitetit të Shoqërisë.

14.4. Administratori i Shoqërisë "ISPP" Sh.p.k mund të shkarkohet para perfundimit të mandatit në rastet e mëposhtme:

a. Nëse është shpallur fajtor me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një veprë penale që ka lidhje me veprimtarinë ekonomiko-financiare;

b. Nëse vërtetohet se ka shpërdoruar fondet e Shoqërisë;

c. Në rast se me vendim të gjykatës kompetente i është kufizuar apo hequr zotesia për të vepruar;

d. Nëse është ndaluar për të administruar dhe drejtuar shoqëritë;

e. Në çdo rast tjetër që pengon në mënyrë të zgjatur Administratorin të kryejë funksionet e tij;

f. Si dhe për çdo arsye të drejtë që vlerësohet nga Ortaku i vetëm.

14.5. Konsiderohet arsye e drejtë për shkarkimin e Administratorit:

a. refuzimi i vazhdueshëm i Administratorit për t'iu nënshtruar rregullave të ligjit dhe dispozitave të Statutit lidhur me miratimin vjetor të llogarive dhe me të drejtën e ortakëve për t'u informuar;

b. administrimi i keq financiar i Shoqërisë "ISPP" Sh.p.k;

c. pavarësisht nga gabimet e Administratorit, do të konsiderohet arsye e drejtë për shkarkimin e Administratorit fakti i humbjes së besimit dhe marrëdhëniet jo të mira me Ortakun, bankierët dhe Administratën publike;

d. Administratori ka ndjekur një politikë personale në administrimin e Shoqërisë dhe nuk ka pranuar sugjerimet e vazhdueshme të Ortakut për mirëadministrimin e Shoqërisë.

14.6. Në rast se shkarkimi i Administratorit është bërë pa arsye të drejtë, atëherë ai mund të kërkojë nga Gjykata caktimin e dëmshpërblimit financiar.

14.7. Edhe nëse është marrë pa një arsye të drejtë, Vendimi për shkarkimin e Administratorit nuk mund të kundërshtohet në Gjykatë nëqoftëse janë zbatuar rregullat e kërkuar nga ligji për shumicën e kërkuar. Në një rast të tillë, Gjykata mund të vendosë vetëm për dëmshpërblimin financiar të Administratorit të shkarkuar.

14.8. Me kërkesë të Ortakut të Shoqërisë "ISPP" Sh.p.k.

Administratori mund të shkarkohet nga Gjykata për shkelje të ligjit ose të Statutit.

14.9. Efektet e Vendimit për shkarkimin e Administratorit fillojnë nga data e marrjes së tij dhe vendimi nuk mund të ketë fuqi prapavepruese.

NENI 15

Dorëheqja e Administratorit

15.1. Administratori qoftë Ortak ose jo, mundet në çdo kohë të japë dorëheqjen, por nëse dorëheqja bëhet pa arsye të drejtë, Shoqëria "ISPP" Sh.p.k mund të kërkojë dëmshpërblim financiar në masën që është dëmtuar nga kjo dorëheqje.



15.2. Njoftimi i dorëheqjes e bën dorëheqjen përfundimtare dhe Administratori nuk mund të rimarrë funksionet e tij.

NENI 16 **Kompetencat e Administratorit**

16.1. Administratori ka të gjitha kompetencat për të kryer të gjitha veprimet në emër dhe për interes të Shoqërisë "ISPP" Sh.p.k me përjashtim të atyre kompetencave që ligji dhe/ose ky Statut i japin shprehimisht Ortakut të vetëm.

16.2. Administratori ka të drejtë të përfaqësojë Shoqërinë para të tretëve dhe të gjitha vendimet menaxheriale të Shoqërisë "ISPP" Sh.p.k duhet të nënshkruhen të pakten nga Administratori.

16.3. Ortaku i vetëm mund t'i japë autorizim paraprak Administratorit për kryerjen e operacioneve të caktuara ose lidhjen e kontratave të cilat konsiderohen tepër të rëndësishme për Shoqërinë.

16.4. Megjithatë, pa përjashtuar masa të tjera më të detajuara dhe rregullore të brendshme të Shoqërisë, veprimet dhe kompetencat e mëposhtme Administratori mund t'i kryejë vetëm me autorizim paraprak të Ortakut:

- a) përcaktimi dhe ndryshimi i programit të veprimtarisë afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë të Shoqërisë "ISPP" Sh.p.k ;
- b) kryerja e investimeve dhe financimeve për vitin financiar si dhe veprimet apo operacionet e tjera që do të kërkonin ndryshimin e buxhetit fillestar të Shoqërisë;
- c) hapja e veprimtarive ose e njërive të reja, shkrija ose bashkimi dhe mbyllja tërësisht a pjesërisht e veprimtarive dhe njërive të Shoqërisë;
- d) blerja, shkëmbimi dhe shitja e pasurive që përbëjnë aktivin e qëndrueshëm të Shoqërisë;
- e) themelimi nga ana e Shoqërisë "ISPP" Sh.p.k të shoqërive ose pjesëmarrja në shoqëri të tjera të krijuara, ose për t'u krijuar;
- f) marrja e huave afatmesme, afatgjata, dhënia e dorëzaneve ose e garancive të tjera, kur këto të fundit tejkalojnë veprimtarinë e zakonshme të Shoqërisë;
- g) negociimi, përfundimi a ndryshimi i çdo kontrate me afat mbi 5 vjet.
- h) përcaktimi i kriterëve për diskutimin, përfundimin dhe ndryshimin e kontratës së punësimit me punonjësit;
- i) si dhe ato vendime ose masa që e kapërcejnë veprimtarinë e zakonshme të Shoqërisë dhe që janë të tilla që mund të sjellin ndryshime në objektin e Shoqërisë.

16.5. Administratori mund të delegojë një pjesë të kompetencave të tij, që ai i gëzon të dobishme tek një ose disa persona të tjerë që kryejnë funksione teknike në aktivitetin e Shoqërisë.



16.6. Administratori mund t'u delegojë personave të tjerë ortakë ose jo, disa nga kompetencat e tij për ushtrimin e funksioneve të veçanta. Administratori nuk mund të delegojë tërësinë e kompetencave të tij.

NENI 17

Administrimi i Shoqërisë nga disa Administratorë

17.1. Ortaku i vetem në çdo moment, mund të vendosë që Administrimi i Shoqërisë "ISPP" Sh.p.k të kryhet nga disa Administratorë.

17.2. Në këtë rast, marrëdhëniet midis administatoreve, kompetencat, te drejtat dhe detyrimet e secilit mund të rregullohen në rregullore të veçantë ose të parashikohen në vendimin e Ortakut të vetem.

17.3. Ortaku i vetem mund të kufizojë kompetencat dhe te drejtat e secilit Administrator dhe/ose të vendosë që ata të ushtrojnë kompetencat e tyre me vendime të përbashkëta dhe të drejta firme të përbashkëta ose secili prej Administratorëve të ketë kompetencat të veçanta.

17.4. Administrimi i Shoqërisë "ISPP" Sh.p.k nga disa administratorë i jep të drejtën secilit prej tyre të kundërshtojë çdo operacion të projektuar nga Administratori tjetër përpara se operacioni të ketë përfunduar.

17.5. Kundërshtimi i një Administratori për një ose disa operacione që kërkon të kryejë Administratori tjetër, është një akt që e çliron atë nga përgjegjësia ndaj Ortakut të vetem për veprimet e Administratorit tjetër.

17.6. Kundërshtimi i shfaqur nga një Administrator ndaj veprimeve të Administratorit tjetër, është pa pasoja ose efekte ndaj të tretëve, përveç rastit kur është provuar se të tretët nuk kanë pasur dijeni për këtë përgjegjësi të përbashkët të Administratorëve.

17.7. Në rast se disa administratorë janë bashkëfajtorë për veprimet e kryera gjatë administrimit të Shoqërisë, masa e kontributi që duhet të paguajë secili për shlyerjen e dëmit, vendoset nga gjykata.

NENI 18

Të drejtat e Administratorit

18.1. Administratori për punën e kryer shpërblehet, por funksionet e tij mund të jenë pa shpërblim nëse ai ka shprehur vullnetin e tij për këtë klauzolë.

18.2. Shpërblimi i Administratorit përcaktohet me vendim të Ortakut të vetem ose në Aktin e Emërimit të tij dhe mund të jetë ose në shumë fikse ose në përpjestim me të ardhurat e Shoqërisë "ISPP" Sh.p.k

18.3. Administratori ka të drejtën e rimbursimit të shpenzimeve që ai kryen gjatë ushtrimit të funksioneve të tij.

NENI 19

Përgjegjësia e Administratorit

19.1. Në marrëdhënie me të tretët, Administratori është përfaqësuesi ligjor i Shoqërisë "ISPP" Sh.p.k



19.2. Çdo ortak joadministrator ka të drejtë dy herë në vit t'i paraqesë me shkrim Administratorit disa pyetje për ato probleme që mendon se përbëjnë shqetësim për veprimtarinë e shoqërisë. Për pyetjet e bëra Administratori është i detyruar t'i përgjigjet me shkrim.

19.3. Shoqëria merr përsipër detyrimet që rrjedhin nga veprimet e administrimit të Shoqërisë të kryera nga Administratori edhe kur këto veprime nuk përfshihen në objektin e shoqërisë. Shoqëria "ISPP" Sh.p.k nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i Administratorit e kalonte objektin e Shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë fakt në rrethanat e krijuara.

19.4. Administratori është përgjegjës individualisht ndaj Shoqërisë apo të tretëve për:

- a. shkelje të ligjeve;
- b. për shkelje të Statutit, apo
- c. për faje të kryera gjatë administrimit të Shoqërisë.

19.5. Mund të kërkohet përgjegjësia civile e Administratorit në rastet e neglizhencës, pakujdesisë apo manovrave mashtruese, të cilat do të konsiderohen faje të kryera gjatë administrimit të Shoqërisë, të tilla si:

- a. porosi mjaft e madhe nga Administratori për mallra ose shërbime kur Shoqëria është deficitare;
- b. mungesa e mbikqyrjes mbi një bashkeadministrator i cili ka vjedhur fonde të Shoqërisë;
- c. mosinformimi i Ortakut për gjendjen financiare jo të mirë të Shoqërisë;
- d. lidhja e një kontrate me kushte shumë të demshme për Shoqërinë;
- e. dhenia të tretëve e komisioneve të fshehta;
- f. zbatimi i keq i një vendimi të Ortakut të vetëm;
- g. mospagimi i kuotave të sigurimeve shoqërore, kur gjendja e likuiditeteve të Shoqërisë e mundësonte një gje të tillë,
- i. kryerja e mashtrimeve tatimore;
- j. shfaqja e neglizhencës që ka sjelle denimin e shoqërisë me demshperblim financiar për konkurrence të pandershme;
- k. si dhe çdo rast tjetër që përbën shkak për shkarkimin e tij sipas këtij Statuti.

19.6. Nëqoftë se Administratori shkel një klauzolë të Statutit që kufizon kompetencat e tij Ortaku mund t'i kërkojë atij zëvendësimin e dëmit të shkaktuar nga ky veprim. Mosnjohja e Statutit përbën një arsye të drejtë për shkarkimin e Administratorit dhe privimin nga e drejta e dëmshperblimit financiar për shkarkimin.



19.7. Padia që njih dhe vendos për përgjegjësinë civile të Administratorit për veprimet e kryera mund të ngrihet nga Ortaku paditës duke e ndjekur në rrugë gjyqësore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar Shoqërisë "ISPP" Sh.p.k nga veprimet e Administratorit, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme.

19.8. Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht, ortaku i vetem ka të drejtë të ngrejë padi penale kundër Administratorit.

19.9. Administratori është i detyruar të ruajë dhe të mos bëjë të ditur mënyrën e vendimmarrjes dhe të veprimit në Shoqërinë "ISPP" Sh.p.k duke trajtuar në mënyrë konfidenciale, informacionin dhe sekretet e shoqërisë, veçanërisht ato industriale dhe të biznesit, për të cilat ai ka marrë dijeni gjatë kryerjes së detyrës së tij. Ky detyrim i Administratorit mbetet i vlefshëm edhe pas largimit të tij nga funksioni në Shoqërinë "ISPP" Sh.p.k.

NENI 20

Eksperti kontabel i autorizuar

20.1. Kontrolli i veprimtarisë së Shoqërisë kryhet nga një ekspert kontabel i autorizuar (person fizik apo Shoqëri).

20.2. Eksperti Kontabel caktohet me vendim të Ortakut të vetem për një periudhë prej 6 vitesh financiare.

20.3. Në Vendimin e Ortakut të vetem për emërimin e Ekspertit Kontabel, përcaktohen edhe kompetencat, funksionet, detyrimet, përgjegjësia, zëvendësueshmëria, tërheqja, shkarkimi dhe shpërblimi tij.

IV. VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE, NDARJA E FITIMIT

NENI 21

Viti Financiar

21.1. Çdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor dhe përputhet me vitin kalendarik. Perjashtimisht viti i parë fillon në ditën e regjistrimit në Regjistrin Tregtar të Gjykatës dhe përfundon në 31 dhjetor.

NENI 22

Llogarite Vjetore

22.1. Me mbylljen e vitit financiar, administratori i shoqërisë bën inventarin dhe llogarite vjetore në përputhje me legjislacionin mbi kontabilitetin. Bilancit i bashkëngjiten: një situacion mbi garancitë e dhëna nga shoqëria dhe një situacion mbi sigurimet e bera nga shoqëria.

22.2. Dokumentet e përmendura në paragrafin e parë të këtij neni vihen në dispozicion të eksperteve kontabel të autorizuar në selinë e shoqërisë.

22.3. Miratimi i dokumenteve mbi veprimtarinë vjetore të shoqërisë bëhet nga Ortaku brenda një afati prej 6 muajsh nga dita e mbylljes së vitit financiar.



NENI 23 **Fitimi**

23.1. Fitimi ose kur eshte rasti humbja e ushtrimit financiar percaktohet nga diferenca midis te ardhurave dhe shpenzimeve te ushtrimit, ne pajtim me rregullat e parashikuara ne legjislacionin mbi kontabilitetin

23.2. Fitimi i ushtrimit mund te destinohet per te krijuar e plotesuar rezervat e shoqerise ose per t'ju shperndare ortakut te vetem.

23.3. Ne rastin e nje humbjeje Asambleja qe miraton llogarite duhet te vendose per mbulimin e humbjes.

NENI 24 **Rezervat**

24.1. Rezerva e domosdoshme nuk mund te perdoret as per tju shperndare ortakut as per shlyerjen apo riblerjen e pjeseve nga shoqeria.

24.2. Ajo perdoret ne rastin e humbjeve kur keto humbje nuk mund te mbulohe (thithen) nga rezerva te tjera.

24.3. Ne rastin kur shoqeria nuk ka te mbartura humbje nga ushtrimet e meparshme masa e fitimeve mbi te cilen llogaritet rezerva e domosdoshme eshte shuma e fitimit te ushtrimit financiar te mbyllur.

24.4. Ne rastin kur shoqeria ka te mbartura humbje nga ushtrimet e meparshme masa e fitimeve mbi te cilen llogaritet rezerva e domosdoshme eshte shuma e fitimeve te mbetura pas zbritjes se humbjeve te mbartura.

24.5. Heqja nga fitimet per krijimin e rezerves ose per te ushqyer rezerven e domosdoshme eshte te pakten 1/20 e mases se fitimeve. Kjo heqje nuk eshte e detyrueshme kur rezerva e domosdoshme arrin 1/10 e kapitalit themeltar.

NENI 25 **Shperndarja e Fitimit**

25.1. Fitimi qe do te shperndahet perbehet nga fitimi i ushtrimit perkates te cilit:

- a. i zbriten humbjet e mbartura dhe shumat qe hiqen per rezervat
- b. i shtohen fitimet e mbartura.

NENI 26 **Dividentet**

26.1. Ortaku i vetem mund te vendose shperndarjen e dividenteve vetem pasi:

- a. nga njera ane te kete miratuar llogarite vjetore;
- b. nga ana tjeter te kete percaktuar shumen qe do te shperndahet.



NENI 27
Vendimi per humbjet

27.1. Ne rastin kur rezultati i ushtrimit te mbyllur eshte humbje, Ortaku i vetem mund te vendose:

a. ose mbartjen e kesaj humbjeje ne ushtrimin e ardhshem, duke kaluar ne nje llogari te vecante "humbje te mbartura"

b. ose pastrimin e saj nga rezervat, duke perfshire edhe rezerven e domsdoshme.

27.2. Vetem kur humbjet e mbartura te jene pastruar teresisht mund te rifilloje shperndarja e fitimeve.

NENI 28
Detyrimi per te perballuar humbjet

Cdo marreveshje qe parashikon perjashtimin e ortakut nga perballimi i humbjeve eshte i pavlefshem.

Nese shoqeria priset dhe vihet ne likuidim, atehere likuidatori eshte i detyruar te shlyeje te paret kreditorët e saj.

NENI 29
Publikimi

29.1. Cilido qofte vendimi i marre nga ortakut, prishje apo vazhdimi i shoqerise, ai duhet te publikohet ne nje gazete te autorizuar per publikime ligjore dhe te regjistrohet ne regjistrin tregtar.

NENI 30
Bilanci

30.1. Bilanci vjetor i shoqerise nxirret brenda 31 Marsit te vitit pasardhes.

V. PRISHJA E SHOQERISE DHE LIKUIDIMI

NENI 31
Humbja e gjysmes se kapitalit.

31.1. Ne rast se kapitalet e veta te shoqerise per shkak te humbjeve te konstatuara ne dokumentet kontabel rezultojne me te uleta se gjysma e kapitalit themeltar, atehere Ortaku duhet te vendose, mbi mundesine e prishjes se shoqerise brenda 4 muajve nga data e miratimit te llogarive qe pasqyrojne kete humbje.

NENI 32
Rregullimi i gjendjes

32.1. Neqofte se ortakut i vetem ka vendosur ta mbajne shoqerine atehere ka nje afat prej nje viti nga data e mbylljes se ushtrimit kur eshte konstatuar gjysma e humbjes se kapitalit per te plotesuar kapitalet e veta.



32.2. Neqoftese plotesimi i kapitaleve te veta nuk arrihet atehere shoqeria duhet te procedoje ne zvogelimin e kapitalit ne nje vlere jo me te vogel se ajo e humbjeve qe kane mbetur te pambuluara nga rezervat. Por duhet mbajtur parasysh qe kapitali nuk mund te jete nen minimumin e kerkuar nga neni 38 i ligjit nr. 7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare".

NENI 33
Likuidimi

34.1. Shoqeria priset me vendim te Ortakut te vetem dhe ne perputhje me dispozitat ligjore qe zbatohen ne Republiken e Shqiperise.

VI. DISPOZITAT E FUNDIT
NENI 34
Mosmarveshjet

35.1. Per te gjitha mosmarveshjet brenda shoqerise qe mund te lindin gjate veprimtarise se shoqerise dhe qe nuk mund te zgjidhen me mirekuptim, organi kompentent do te jete Gjykata e rrethit gjyqesor Tirane.

35.2. Ky Statut redaktohet ne 5 kopje origjinale ne gjuhen shqipe dhe nenshkruhet me vullnetin e tij te lire nga ortaku themelues.

ORTAKU I VETEM

ARBEN PETTO



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

NR. 751 REP.
NR. 86 KOL.

Lindita Kokona

VERTETIM

Ne Tirane, sot ne date 09.03.2007 (dymije e shtate) para meje Noteres Lindita KOKONA, anetare e Dhomes se Notereve Tirane, me zyre ne Bulevardin "Gjergj Fishta", u paraqit personalisht :

ZARBEN PETTO, datelindja 21.02.1960, banues ne Tirane Rruga "Abdyl Frasher", me cilesine e Administratorit dhe Ortak i Vetem i Shoqerise "Instituti i Studimeve dhe Projektimeve Pyjore", i cili me vullnetin e tij te lire dhe te plote nenshkroi para meje Statutin e Shoqerise "Instituti i Studimeve dhe Projektimeve Pyjore" Shpk, dhe une noterja vertetoj sipas ligjit nenshkrimin e tij.

Baza Ligjore : Ligji "Per Noterine".

**NOTER
LINDITA KOKONA**

Lindita Kokona



**AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"Instituti i Studimeve dhe Projektive Pyjore" Sh.p.k**

"INSTITUTI I STUDIMEVE DHE PROJEKTIVE PYJORE" Sh.p.k, perfaqesuar nga administratori i shoqerise Z. **ARBEN PETTO**

Ne Tirane, sot me date 09.03.2007, perpara meje, Liudita Kokona, noter i Dhomes se Notereve Tirane, u paraqit personalisht:

Z. Arben Petto, person me shtetesi shqiptare, i datelindjes 21/2/1960, me adrese banimi Rruga "Abdyl Frasheri", Tirane, Shqiperi. Mbajtes i Pasaportes me Nr Z 0116878, person me zotesi te plote juridike per te vepruar, ne pranine time, nenshkroi kete Akt Themelimi te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar **"INSTITUTI I STUDIMEVE DHE PROJEKTIVE PYJORE" Sh.p.k.**

Neni 1

Forma e shoqerise

Ortaku i vetem themelon nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar.

Neni 2

Emertimi i shoqerise

Emertimi i plote i shoqerise eshte "Instituti i Studimeve dhe Projektive Pyjore". Emertimi i shkurtuar eshte **"ISPP" Sh.p.k.**

Neni 3

Baza juridike

Shoqeria e ushtron aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe ne perputhje me dispozitat e Statutit e Aktit te Themelimit.

Neni 4

Objekti i veprimtarise

Shoqeria "INSTITUTI I STUDIMEVE DHE PROJEKTIVE PYJORE" Sh.p.k ushtron veprimtarine e saj me qellim realizimin e fitimit, duke u mbeshtetur ne parimet e likuiditetit, sigurise dhe rentabilitetit, sipas rregullave te parashikuara nga legjislacioni shqiptar.

Veprimtaria e Shoqerise "INSTITUTI I STUDIMEVE DHE PROJEKTIVE PYJORE" Sh.p.k, do te ketë per objekt;

Veprimtaria e Shoqerise **"Instituti i Studimeve dhe Projektive Pyjore" Sh.p.k** do te ketë per objekt :

Ne fushen e Studimeve dhe projektive pyjeve objekti do te jete:

- per hartimin e planeve te menaxhimit te pyjeve, flores spontane, gjuetise sportive e turistike dhe kullotave.
- per hartimin e projekteve te pylllezimit

- për hartimin e projekteve të shfrytëzimit të qëndrueshëm të pyjeve
- për hartimin e projekteve të menaxhimit të pellgjeve ujëmbledhës
- për studimin e menaxhimit e përdorimit të territorit

Ne fushen e zbatimit te punimeve pyjore objekti do te jete ;

- për pyllëzimet(fidanishtet, grumbullimin e trajtimin e farerave, punimet përgatitore e mbjellje fidanësh)
- për përmirësimin e pyjeve(ricungim e trajtim pyjesh me prerje kulturore)
- për shfrytëzimin e qëndrueshëm të pyjeve
- për sistemimet malore.
- për ndërtimin e rrugëve pyjore.
- për punimet në kullota, livadhe dhe ndërtimin e merementimin e veprave për sigurimin e ujit të pijshëm në kullota e livadhe.

Ne fushen e ndertimeve, ne zbatim :

- Gërmime dhe me punime eventuale murature e betonarme – prishje dhe punime në tokë të gërmuar.
- Prodhim materiale inerte –gurë.
- Prodhim elemente betoni e betonarme të zakonshëm – 2. paranderur – 3. gurë dekorativë – mermer.
- Ndërtime civile – industriale – turistike – bujqësore deri në 5 kate.
- Ndërtime civile – industriale – turistike – bujqësore mbi 5 kate – Rikonstruksione.
- Ndërtim banese me skelet mbi 8 kate.
- Ndërtim rruge kategoria IV dhe V.
- Ndërtim rruge kategoria III dhe II.
- Punime të mirëmbajtjes dhe sinjalizimit në rrugë, ndërtim mbishtresa rrugore.
- Ndërtim ura dhe vepra arti deri në 10 m.
- Ndërtime portuale – bankina – basene - pontile.
- Ndërtim ujësjellës – kanalizime –kanale e impiante vaditjeje.
- Ndërtim diga – damba deri 10 m.
- Sillose, kulla, kulla uji etj., prej betonarme- metalike.
- Përforcime themeli e punime nëntokësore.
- Izolime mbi dhe nëntokësore nga ujërat.
- Themele të veçanta.
- Punime karpentjerie druri.
- Punime karpentjerie metali.
-
- Instalim i impianteve higjenike, kuzhina, lavanteri, hidrosanitare- mirembajtja e tyre
- Instalim i materialeve prej druri-metalike plastike-xhami.
- Punime bojatisje – hidroizolimi – termoizolimi – akustikë – kundra zjarrit.

Neni 5 Selia

Selia e Shoqërisë "ISPP" Sh.p.k. është ne adresen: Rruga "Myslym Shyri", Pallati 6, Ap 35, Tirane, Shqipëri.



Shoqeria mund te hape dege dhe filiale brenda dhe/ose jashte vendit.

Neni 6 Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine per nje periudhe te pacaktuar kohore.

Neni 7 Kapitali i shoqerise

Kapitali themeltar i shoqerise "Instituti i Studimeve dhe Projekttimeve Pyjore" Sh.p.k eshte 100 000 (njqind mije) Leke, i ndare ne 100 pjese me vlere nominale prej 1.000 (nje mije) leke secila.

Neni 8 Administrimi

Shoqeria do te administrohet nga nje Administrator i Vetem.

Administratori i pare i shoqerise eshte **Z. Arben Petto**, person me shtetesi shqiptare, i datelindjes 21/2/1960, me adrese banimi Rruga "Abdyl Frasher", Tirane, Shqiperi, Mbajtes i Pasaportes me Nr Z 0116878.

Neni 9 Viti financiar

Vitet financiare perputhen me vitin kalendarik. Viti financiar fillon me 1 Janar dhe mbyllet me 31 Dhjetor te cdo viti kalendarik. Perjashtimisht, viti i pare financiar do te filloje nga data e regjistrimit te shoqerise ne Regjistrin Tregtar dhe do te mbyllet ne fund te vitit perkates.

Neni 10

Te ardhurat neto te shoqerise i takojne ortakut te vetem themelues te shoqerise. Te ardhurat qe do te rezultojne ne fund te mbylljes se cdo ushtrimori, ne perputhje me parashikimet e statutit dhe pas pagimit te tatimeve, dhe rezerves se domosdoshme, te konkretizuara ne bilance, mund ti ndahen ortakut te vetem.

Neni 11

Ky Akt themelimi i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar, eshte hartuar ne 5 kopje ne gjuhen Shqipe me fuqi te njejte ligjore dhe te nenshkruara rregullisht nga ortaku i vetem.

ORTAKU I VETEM

ARBEN PETTO

NOTERI

**NOTERE
LINDITA KOKONA
TIRANE ALBANIA**

Arben Petto
[Signature]

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERËVE TIRANË
NR. 698 Rep
Nr. 78 Kol



PROKURË E POSAÇME

Ne Tiranë, sot ne date 05.03.2007 (dymije e shtate) para meje Noteres LINDITA KOKONA anetare e Dhomes se Notereve Tirane, me zyre ne "15. Ghergji H. Hato", u paraqit personalisht :

Z. Arben Petto, person me shtetesi shqiptare, i datelindjes 21/2/1960, me adrese banimi:Rruga "Abdyl Frasheri", Tirane, Shqiperi. Mbajtes i Pasaportes me Nr Z 0116878, madhor e me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, i cili me kerkoi redaktimin e kesaj prokure te posacme ne baze te nenit 70 e vijues te Kodit Civil, duke me deklaruar se :

Emeroj perfaqesuesit e mi te posacem Av. Artan Bozo me License Nr. 996, Av. Ketrin Topçiu, me licencen Nr.2483, dhe Olsi IBRO, te cileve i jap te drejte dhe kompetence te plote, qe ne emer dhe per llogarine time, te me perfaqesojne te tre se bashku apo sejcili prej tyre, ne te gjithë veprimet e nevojshme prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, per kryerjen e procedurave per regjistrimin e Shoqerise "Instituti i Studimeve dhe Projektimeve Pyjore" Sh.p.k. duke kerkuar, dorezuar apo terhequr cdo dokument apo akt qe lidhet me mbrojtjen e interesave te mia.

Perfaqesuesit e mij kane te drejte qe per kryerjen e procedurave te nevojshme, per perfaqesimin dhe mbrojtjen e interesave te mia te kryejne cdo veprim juridik te domosdoshem prane organeve gjyqesore, te administrates publike apo prane cdo strukture tjeter shteterore.

Veprimet e mesiperme te kryera nga perfaqesueit e mij i konsideroj te drejta sikur te isha vete i pranishem ne kryerjen e tyre.

Prokura e mesiperme u perpilua nga une noterja dhe pasi ju lexua dhe u gjet sipas vullnetit te lire te perfaqesuarit, kuptohet, pranohet dhe nenshkruhet prej tij.

Une noterja e vertetoj sipas ligjit.


I PËRFAQËSUAR

Arben Petto

NOTER

NOTERE
LINDITA KOKONA
TIRANE ALBANIA

KONTRATE PUNE



Ne perputhje me dispozitat e Kodit te Punes, te nenit 25 te Rregullores "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për punët publike", miratuar me urdhërin e Ministrit të Puneve Publike, transportit dhe telekomunikacionit nr. 84, datë 8.9.2006, hartohet kjo kontrate pune me drejtuesin teknik si vijon:

Ndërmjet

Shoqërisë "Instituti i Studimeve dhe Projektimeve Pyjore" Sh.p.k, perfaqesuar nga administratori i shoqërisë Z. Arben Petto, ketu e me poshte e quajtur Punedhenesi.

Dhe

Z. Vangjel Nashi, person fizik, lindur dhe banues ne Lushnje, mbajtes i licenses profesionale N. Z.4453/1 leshuar nga Komisioni i Dhenies se Licensave Profesionale prane Ministrise se Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit ketu e me poshte i quajtur Punemarresi.

Palët bien dakort me kushtet e mëposhtme:

I. Detyra dhe Kohëzgjatja e Kontratës

Pozicioni i Punëmarrësit është Drejtuesi Teknik i shoqërisë ISPP Sh.p.k. Kjo kontratë hyn në fuqi nga data e pajisjes te Punedhenesit me License Profesionale nga ana e Komisionit te Dhenies se Licensave Profesionale prane Ministrise se Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit ("Data e Fillimit") dhe eshte me kohëzgjatje 3(tre) vjet.

Secila pale ka te drejte ta zgjidhe kete kontrate per cfaredolloj arsyeje duke i dhene njoftim me shkrim pales tjetere sipas afateve dhe procedures se percaktuar ne nenin XII te kesaj kontrate.

II. Vendi i Punës

Punëmarrësi do të punojë në zyrat e Shoqërisë në adresën Rruga "Myslym Shyri", Pallati 6, Ap 35, Tirane, Shqipëri dhe kur është e nevojshme, në vende të tjera pune brenda Shqipërisë në përputhje me nevojat e Shoqërisë.

Shoqëria ka të drejtë ta caktojë Punëmarrësin në çdo vend pune për të njëjtat detyra dhe në të njëjtin pozicion siç përcaktohet në kontratë, në përputhje me nevojat e saj. Për këtë qëllim, Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë përkohësisht ose në mënyrë të përhershme vendin e punës së Punëmarrësit brenda ose jashtë selisë së Shoqërisë pa i dhënë atij/asaj një shpërblim shtesë dhe pa e konsideruar këtë ndryshim të njëanshëm ose të dëmshëm, për sa kohë që kjo bazohet në këtë kontratë të nënshkruar nga Punëmarrësi.

Çdo ndryshim i tillë do t'i komunikohet Punëmarrësit personalisht ne kohën e duhur dhe do të regjistrohet. Punëmarrësi nuk duhet ta ndërpresë këtë marrëveshje në mënyrë të paarsyeshme për shkakun e sipërpërmendur. Përcaktimi i arsyeshmërisë së çështjes është vetëm në diskrecionin e Shoqërisë. Çdo ndryshim i vendit të punës nuk duhet te gjykohe si nje ndryshim i kushteve të kësaj kontrate pune në tërësi.

a) Punësimi në Shoqëritë e Lidhura ose Shoqëri në të cilat Shoqëria është Pjesëmarrëse

Sipas kësaj kontrate, Punëmarrësi bie dakort t'i shërbejë Shoqërisë dhe në rastet kur i kërkohet nga kjo e fundit, t'i shërbejë edhe shoqërive të tjera të lidhura me Shoqërinë, apo shoqërive në të cilat Shoqëria është pjesëmarrëse, shoqëri të cilat ekzistojnë ose do të ekzistojnë në të ardhmen.

Punësimi i Punëmarrësit në këtë Shoqëri dhe në një ose më shumë shoqëri të lidhura me të, ose shoqëri në të cilat Shoqëria është pjesëmarrëse, gjatë orëve normale të punës nuk i jep atij/asaj të drejtën e një shpërblimi shtesë.

III. Koha e Punes dhe Orari i Punës

Kohezgjatja normale ditore e punes eshte tete ore, dhe kohezgjatja normale javore e punes eshte 40 ore. Ky orar pune mund te jete subjekt i ndryshimeve të mëtejshme dhe Shoqëria është personi i vetëm që ka te drejten për të bërë ndryshime të tilla në përputhje me Kodin e Punës së Shqipërisë. Oret e fillimit dhe mbarimit të punes (orari i punes) percaktohen ne rregulloren e brendshme te Shoqerise.

Orari i fillimit dhe mbarimit të pushimit percaktohet ne rregulloren e brendshme te Shoqerise.

Nëse pozicioni i punës së Punëmarrësit kërkon të punohet me turne, koha normale e punes do te percaktohet sipas listës së turneve të aprovuara nga Ponedhnesi.

IV. Paga Mujore

Punëmarrësit do t'i paguhet një pagë baze bruto prej 40 000 (dyzetemijeleke) LEKE, nga e cila Shoqëria do te zbresë kontributin e sigurimeve shoqërore dhe shumën e tatimit mbi te ardhurat personale. Paga neto do te paguhet në një llogari personale të Punëmarrësit. Çdo ndryshim i mëvonshëm i pagës i njoftohet Punëmarrësit me shkrim. Përveç kësaj page, Punëmarrësi nuk ka të drejtën të kërkojë ndonjë shpërblim tjetër nga Shoqëria.

Shoqëria do të paguajë pagën dhe çdo shpërblim tjetër pas kryerjes së punës, në ditën e fundit të punes te çdo muaji.

Në lidhje me çdo lloj pagese që Shoqëria i bën Punëmarrësit, e cila nuk është e detyrueshme në bazë të ligjit, Shoqëria rezervon të drejtën ta revokojë dhënien e saj në çdo kohë.

V. Trainimi

Shoqëria merr përsipër t'i sigurojë Punëmarrësit trainim të përshtatshëm brenda ose jashtë Shqipërisë, në rastet kur Shoqëria e gjykon të arsyeshme.

Te gjitha shpenzimet per trainimin e punemarresit jane ne ngarkim te Ponedhnesit.

Ne rast se Punemarresi nuk respekton afatet dhe menyren e parashikuar per zgjidhjen e kontrates ose nuk respekton detyrimet per ruajtjen e sekretit dhe te te dhenave te tjera per te cilat eshte vene ne dijeni gjate kohes se punesimit, ose shkel detyrimet e marra persiper per moskryerjen e konkuresces, atehere punemarresi detyrohet ti ktheje ponedhnesit te gjitha shpenzimet e bera prej tij per trainimin e punemarresit brenda ose jashte vendit. Ne keto shpenzime perfshihen por nuk kufizohen, pagesat e bera per ndjekjen e kurseve profesionale,

pagesat per pedagoget e ketyre kurseve, shpenzimet e udhetimit e te dietave dhe shpenzime te tjera te kryera per kete qellim.

VI. Pushimet dhe Lejet

Pushimet Vjetore. Punëmarrësi ka të drejtën e pushimeve vjetore të paguara prej kater javësh kalendarike (28 ditë kalendarike), te cilat merrren me miratimin e Shoqërisë. Në rastin kur Punëmarrësi nuk ka mbushur një vit të plotë pune, Shoqëria përcakton kohëzgjatjen e pushimeve vjetore të paguar në raport me kohëzgjatjen faktike të punësimit të Punëmarrësit në Shoqëri. Pushimet e paguara, te marra përpara se Punëmarrësi të ketë kryer ditët e nevojshme të punës, mund t'i jepen më përpara Punëmarrësit vetem me miratimin e punedhënesit.

Punëmarrësi ka gjithashtu të drejtën e pushimeve te tjera të cilat Shoqëria i gjykon të arsyeshme.

VII. Mungesa në Punë

- i. Punëmarrësi duhet t'i komunikojë Shoqërisë mungesën e tij/saj në punë për çfarëdo arsye brenda 24 orëve. Në rast se një komunikim i tillë nuk merret nga Shoqëria, kjo e fundit ruan të drejtën që t'i trajtojë këto ditë si leje pa pagesë. Gjithashtu, Punëmarrësi i nënshtrohet masave disiplinore, duke përfshirë edhe largimin nga puna.
- ii. Nëse Punëmarrësi pengohet të kryejë punën e tij për shkak të *forcës madhore*, ai/ajo duhet të njoftojë Shoqërinë sa më shpejt të jetë e mundur dhe duhet të paraqitet në punë menjëherë pasi këto rrethana të jenë eliminuar.
- iii. Sëmundja e Punëmarrësit përfshihet gjithashtu në *forcën madhore*. Në këto raste, Punëmarrësi duhet të lejojë doktorin e Shoqërisë t'i bëjë një kontroll mjekësor atij. Gjithashtu, Punëmarrësi duhet t'i sjellë Shoqërisë brenda tre ditësh nga dita e parë e mungesës në punë, raportin e ligjshëm, i cili justifikon sëmundjen e tij dhe mungesën në punë. Mosparaqitja e këtyre raporteve është një arsye për t'a cilësuar mungesën e Punëmarrësit si të pajustificuar.

VIII. Detyrimet e Punëmarrësit

Punëmarrësi do të ndjeke dhe zbatoje te gjitha punimet e marra persiper nga Shoqeria dhe te parashikuara ne Licensen Profesionale te punemarresit.

- Të njohë dhe të kryejë cdo veprimtari ne emer dhe per Ilogari te Shoqerise në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për projektim, zbatim, punë publike dhe rregullores se miratuar nga Ministria e Puneve Publike.
- Të njohë dhe zbatojë standardet, kushtet teknike të projektimit e zbatimit, si dhe euronormat e pranuar nga vendi ynë.
- Të njohë dhe zbatojë rregulloren e sigurimit teknik në punë.
- Te njohe dhe te zbatoje legjislacionin ne fushen e ndertimit.
- Te njohe dhe zbatoje urdherat dhe udhezimet e dhena nga Shoqeria ne zbatim te projekteve dhe detyrimeve te marra persiper prej saj kundrejt personave te trete dhe / ose autoriteteve publike lokale ose qendrore.

Punëmarrësi kryen detyrat dhe mban përgjegjësitë që i janë caktuar nga Punëdhënësi si dhe ose ato te dhena nga përgjegjësi i drejtperdrejte, si dhe detyra të tjera që mund t'i caktohen Punëmarrësit nga Shoqëria herë pas here. Një përshkrim i përgjithshëm i detyrave dhe përgjegjësiëve ruhet në dosjen personale të Punëmarrësit.

Shoqëria, sipas gjykimit të saj, ka të drejtë ta angazhojë Punëmarrësin edhe në pozicione të tjera.

Punëmarrësi ka detyrimet e mëposhtme:

- i. Detyrimi për t'a kryer punën personalisht. Punëmarrësi është i detyruar t'a kryejë punën personalisht, me përjashtim kur me marrëveshje është rënë dakort ndryshe. Punëmarrësi zëvendësohet ose ndihmohet nga një person i tretë, vetëm kur Shoqëria ka dhënë shprehimisht miratimin e saj. Në këtë rast, personi zëvendësues ose ndihmësi konsiderohet si i punësuar i Shoqërisë. Çdo marrëveshje e kundërt është absolutisht e pavlefshme.
- ii. Detyrimi për bindje. Punëmarrësi duhet të respektojë udhëzimet e përgjithshme dhe të veçanta që i jepen atij nga Shoqëria.
- iii. Detyrimi për t'a kryer punën me kujdes. Punëmarrësi duhet të kryejë me përkushtim detyrat e tij dhe të mbrojë interesat e Shoqërisë në çdo mënyrë. Metoda dhe mënyra e kryerjes së punës diktohen gjithmonë nga Shoqëria, dhe janë objekt i ndryshimeve në përputhje me gjykimin e Shoqërisë, gjithmonë në përputhje me ligjin shqiptar të punës në fuqi.

Në kryerjen e punës, Punëmarrësi duhet të përdorë veglat e punës, makineritë dhe pajisjet e Shoqërisë në përputhje me rregullat e sigurimit të vendosura nga Shoqëria dhe ato të vendosura nga dhe ose te parashikuara nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

Në rast rreziku ose fatkeqësie, Punëmarrësi ndihmon punëmarrësit e tjerë ose Punëdhënësin.

- iv. Detyrimi i përgjegjësisë dhe kthimit. Punëmarrësi është përgjegjës përpara Shoqërisë për çdo gjë që ai ka përfituar në emër të Shoqërisë gjatë punësimit të tij në përputhje me këtë kontratë, në mënyrë të veçantë për shumat në para.

Punëmarrësi i kthen menjëherë Shoqërisë çdo gjë që ai ka marrë për shkak të detyrës së tij.

Punëmarrësi i kthen menjëherë Shoqërisë çdo gjë të prodhuar nga aktiviteti i tij në përputhje me këtë kontratë.

- i. Detyrimi i besnikërisë dhe ndalimi i konkurrencës. Punëmarrësi mbron me besnikëri interesat e ligjshme të Shoqërisë. Punëmarrësi respekton detyrimet që ai ka në lidhje me natyrën konfidenciale të punës dhe mbrojtjen e sekreteve. Shoqëria ruan te drejten ta zgjidhe menjehere kete kontrate pune, ne rast se Punemarresi nuk ka plotesuar ose ka shkelur detyrimet e parashikuara ne kete kontrate. Gjate vlefshmerise se kontrates dhe pas mbarimit te saj, Punemarresi duhet te ruaje faktet, te dhenat dhe informacionin e destinuar te mbetet sekret, qe ai ka pasur dijeni per shkak se eshte ne sherbim te Shoqerise.

Gjatë vazhdimit të kësaj kontrate dhe pa miratimin me shkrim nga ana e Punëdhënësit, Punëmarrësi nuk duhet të angazhohet ose të ketë interes, në mënyrë direkte ose indirekte, në çfarëdo tregti, biznes apo punë, që ka ose mund të ketë konflikt me interesat e Shoqërisë dhe/ose që përfshin përdorimin e kohës së punës, pasurisë, mjeteve ose burimeve të çfarëdo natyre, që i përkasin Shoqërisë.



- v. Përgjegjësia e Punëmarrësit. Punëmarrësi është përgjegjës ndaj Shoqërisë për dëmin e shkaktuar, kur ai shkel detyrimet që lindin nga kjo kontratë për shkak të fajit apo pakujdesise së Punëmarrësit.

Punëmarrësi është përgjegjës për kujdesin që duhet të ushtrojë për shëndetin dhe sigurinë e vetes së tij dhe personave të tjerë që mund të preken nga veprimet ose mosveprimet e tij në punë. Punëmarrësi është gjithashtu përgjegjës për zbatimin e të gjitha rregullave dhe rregullore të miratuara nga Shoqëria. Shkeljet serioze të këtyre rregullave dhe rregulloreve çojnë në fillimin e procedurave dhe pushimin e menjëhershëm nga puna.

IX. Detyrimet e Shoqërisë

- i. Respektimi i personalitetit të Punëmarrësit. Punëdhënësi respekton dinjitetin e Punëmarrësit dhe i siguron atij kushtet e nevojshme për një punë normale.
- ii. Detyrimet e tjera. Gjithashtu, Punëdhënësi duhet të përmbushë të gjitha detyrimet e tjera të përcaktuara në Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë.
- iii. Furnizimi, Materialet, Pajisjet. Shoqëria bie dakort t'i sigurojë Punëmarrësit të gjitha furnizimet, materialet dhe pajisjet e nevojshme për përmbushjen e shërbimeve të kërkuara.
- iv. Shpenzimet e udhëtimeve. Pagesa e përfshirë në Nenin IV nuk përfshin ndonjë shpenzim udhëtimi. Shoqëria do të rregullojë dhe do të paguajë shpenzimet e udhëtimit, duke përfshirë ushqimin dhe strehimin, për përmbushjen e kësaj kontrate.

X. Rregullat e Sjelljes dhe Disiplina:


Nëse Punëmarrësi është gjetur fajtor për sjellje të keqe, pandershme, mashtrim apo çdo vepër penale, çdo shkelje apo moszbatim të çdonjërit prej kushteve të kësaj kontrate, që konsiderohet e rëndë nga Shoqëria, ose për moszbatim apo refuzim për të zbatuar detyrat e ngarkuara sipas kësaj kontrate pune, atëherë Shoqëria ka të drejtë të fillojë Procedurat e Disiplinimit, të cilat mund të përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në, pushimin e menjëhershëm nga puna.

Procedurat e Disiplinimit parashikohen në Politiken dhe Procedurën e Performances së Ulet, Politiken dhe Procedurën e Largimit, si dhe në çdo politike e procedure që mund të miratojë Shoqëria në të ardhmen në lidhje me masat disiplinore. Politikat dhe procedurat e ardhshme në lidhje me masat disiplinore konsiderohen pjesë e kësaj kontrate.

XI. Zgjidhja e Kontratës

Shoqëria rezervon të drejtën t'a zgjidhë këtë kontratë për çdo shkak duke i dhënë njoftim me shkrim Punëmarrësit. Kontrata konsiderohet e zgjidhur në fund të afatit të njoftimit. Kur Punëmarrësi ka kryer deri në gjashtë muaj pune, afati i njoftimit është dy javë. Kur Punëmarrësi ka mbushur më shumë se gjashtë muaj pune dhe është në vitin e parë të kontratës së punës, afati i njoftimit për zgjidhjen e kontratës është 1 (një) muaj, nga viti i dytë e më shumë afati i njoftimit është 2 (dy) muaj.

Punëmarrësi rezervon të drejtën t'a zgjidhë këtë kontratë vetëm në rast se punëdhënësi nuk ka përmbushur detyrimet e vet atë marrë përse në këtë kontratë duke i dhënë njoftim me shkrim Shoqërisë. Afati i njoftimit është 2 muaj.



Pas zgjidhjes së kontratës, e drejta e Punëmarrësit për kompensim pushon. Asnjë shpenzim i çfarëdolloji i marrë përsipër nga Punëmarrësi pas datës që i është paraqitur atij njoftimi për zgjidhjen e kontratës nuk do të rimburohet sipas kësaj kontrate. Në qoftë se Shoqëria i ka dhënë Punëmarrësit ndonjë paradhënie udhëtimi në lidhje me periudhën pas kësaj date, Punëmarrësi duhet menjëherë të kthejë paratë për këtë paradhënie mbi bazën e udhëzimeve të e procedurave të Shoqërisë.

XII. Prona e Shoqërisë

Punëmarrësi duhet të mbrojë dhe mirëmbajë pronën në posedim të Punëmarrësit, në të cilën Shoqëria ka një interes. Dëmtimi ose humbja e Pronës së Shoqërisë, kur është bërë për shkak të fajit apo pakujdesisë së Punëmarrësit, sjell si pasojë përgjegjësinë e Punëmarrësit për riparimin ose zëvendësimin e saj. Shoqëria mund të mbajë nga paga e Punëmarrësit çdo shumë që normalisht i detyrohet t'ia paguajë këtij të fundit dhe që Shoqëria vendos se është e nevojshme për të mbrojtur Shoqërinë nga humbjet.

XIII. Përputhja me Ligjet e Vendit dhe Rregullat e Shoqërisë

Punëmarrësi do t'i bindet të gjithë ligjeve të zbatueshme, si dhe të gjitha rregullave dhe rregulloreve që kanë forcën e ligjit, të cilat kanë të bëjnë ose kanë lidhje me përmbushjen e kësaj kontrate.

Punëmarrësi ka për detyrë t'i bindet dhe të zbatojë të gjitha politikën, procedurat dhe udhëzimet e miratuara nga Shoqëria.

XIV. Nënkontratat

Asnjë pjesë e kësaj kontrate nuk duhet të nënkontraktohet ose transferohet nga Punëmarrësi.

XV. Kjo Kontrate dhe Ndryshimet e Saj

Per çfare nuk është parashikuar në këtë kontrate, zbatohet legjislacioni shqiptar i punës në fuqi.

Kjo kontrate mund të ndryshohet me marreveshjen e paleve. Çdo ndryshim i kësaj kontrate është i vlefshëm vetëm nëse është nënshkruar rregullisht nga të dyja palët dhe konsiderohet pjesë përbërëse e kësaj kontrate.

XVI. Ligji i Zbatueshëm dhe Zgjidhja e Mosmarreveshjeve

Ligji shqiptar zbatohet për këtë kontrate.

Çdo mosmarreveshje midis dy palëve, e cila nuk mund të zgjidhet me mirëkuptim të ndërsjelltë midis palëve do të zgjidhet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe do të shqyrtohet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kjo kontratë është përgatitur në shqip, në katër kopje origjinale.

Palet pasi e lexuan kontratën nënshkruan me vullnetin e tyre të lirë.

PALËT

PUNEDHENESI

Arben Bello
fll

PUNEMARRESI

Vangel Kashi

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR. 752 REP.
NR. 87 KOL.



VERTETIM

Ne Tirane, sot ne date 09.03.2007 (dymije e shtate) para meje Noteres Lindita KOKONA, anetare e Dhomes se Notereve Tirane, me zyre ne Bulevardin "Gjergj Fishta", u paraqiten personalisht :

Z.ARBEN PETTO, datelindja 21.02.1960, banues ne Tirane Rruga "Abdyl Erasheri", me cilesine e Administratorit dhe Ortak i Vetem i Shoqerise "Instituti i Studimeve dhe Projektimeve Pyjore", dhe **Z.Vangjel NASHI**, i biri i Alekos, datelindja 22.06.1959, mbajtes i licences profesionale Nr.Z.4453/1, te cilet me vullnetin e tyre te lire dhe te plote nenshkruan para meje Kontraten e Punes, dhe une noterja vertetoj sipas ligjit nenshkrimin e tyre.


Baza Ligjore : Ligji "Per Noterine".

NOTER
LINDITA KOKONA

LIÇENSA
Z.4453/1

MBIEMRI
EMRI
ATESIA
DATELINDJA
VENDBANIMI
DIPLOMUAR, ME
TITULLI
Regjistruar ne Regjistrin
themeltar qe nga data

NASHI
VANGJEL
ALEKO
22.06.1959, Lushnje
LUSHNJE
1985
Ing. Hidroteknik
11.05.2006




NE ZBATIM

- Kat. 1** Germime dhe me punime eventuale murature e beton arme – prishje dhe punime ne toke te germuar.
- Kat. 2** **a** Prodhim materiale inerte - gure .
c Prodhim elemente betoni e betonarme te zakonshme – paranderur – gure dekorativ.
- Kat. 3** **a** Ndertime civile – industriale – turistike - bujqesore, deri ne 5 kate
b Ndertime civile – industriale – turistike – bujqesore mbi 5 kate - Rikonstruksione
c Ndertime banesa me skelet mbi 8 kate.
- Kat. 4** **a** Ndertim rruge kategoria IV dhe V.
b Ndertime rruge kat.(III dhe II)
c Punime te mirembajtjes dhe sinjalizimit ne rruge ,ndertim mbishtresa rrugore.
- Kat. 6** **a** Ndertim ura dhe vepra arti deri 10 m.
- Kat. 7** **a** Ndertime portuale – bankina – basena – pontile.
- Kat. 8** **a** Ndertim ujsjelles – kanalizime – kanale e impiante vaditje.
e Ndertim diga – damba deri 10 m.
- Kat. 9** **a** Sillosa, kulla, kulla uji etj prej b/arme - metalike.
b Perforcim themeli e punime nen tokesore.
c Izolime mbi dhe nen tokesore nga ujrat.
d Themele te vecanta.
- Kat. 11** **a** Punime karpentjerie druri
b Punime karpentjerie metalike
- Kat. 12** **c** Instalimi I impianteve higjenike,kuzhina,lavanteri,hidrosanitare – mirembajtja e tyre
e Instalimi I materialeve prej druri – metalike plastike – xhami.
f Punime bojatisje – hidroizolim – termoizolim – akustike – kundra zjarrit

KRYETARI I KOMISIONIT

Stavri Ristani
Stavri RISTANI




REPUBLIKA E SHQIPERISE
ZYRA E NOTERISE LUSHNJE
NR. REP. 719

VERTETIM

Lushnje me 02.3.2007

“ VERTETOHET SE NJESIA ESHTË KOPJE E NJEJTE ME DOKUMENTIN ORIGINAL “.

Dokumenti u paraqit nga z/zj. Vangjel Naste



NOTERE
ERLETA SOTA



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr. 1208 Rep.

STUDIO NOTERIE
MALLKUCI & SADUHAJ

VERTETIM

Sot me date 07-3 2007, para meje A. MARRUCI notere ne qytetin Tirane, me zyre ne Rr. "Vaso Pasha", Pall. 13/1, u paraqit personalisht,

Andrian Kanan Pina, lindur me 11-06-1953 me banim ne Tirane, me dokument identifikimi nr. QH 333859, i/e cili me paraqiti origjinalin e dokumentit Leje Profesionale per Person fizik nr 382 qe i perket z. Arben Petta dhe une noterja vertetoj se fotokopja eshte e njejte me origjinalin.

NOTERE

**DREJTORIA E PERGJITHSHME
E PYJEVE DHE KULLOTAVE
KOMISIONI I LEJEVE PROFESIONALE**



LEJE PROFESIONALE

Personit Fizik, Nr 382

I jepet leja profesionale **... Arben PETTO** si person fizik dhe regjistrohët ne regjistrin themeltar nga data 10.10.2005 si me poshte:

Studime e projekttime te punimeve pyjore.

1. Per hartimin e planeve te menaxhimit te pyjeve, si ato spontane, gjuetise sportive e turistike dhe kullotave.
2. Per hartimin e projekteve te pyllcimit.
3. Per hartimin e pajet teve te shfrytezimit te qendrushem te pyjeve.
4. Per studimin e mbri/shmerise dhe ndertimin e rrugëve pyjore.
5. Per studimin e menaxhimit e penderimit te terrenit.

Ne fushen e zbatimit te punimeve pyjore:

1. per pyllcimet -(fidanishtet, grumbullimin e trajtimin e farerave pyjore, punimet per gatitore e mbjellje fidanash).
2. per permiresimin e pyjeve (ricungjime e trajtim pyjesh me prerje kulturore).
3. per shfrytezimin e qendrushem te pyjeve
4. per sistemit malore
5. per ndertimin e rrugëve pyjore
6. per punimet ne kullota , livadhe dhe ndertimin e meremetimin e veprave per sigurimin e ujit te pijshem ne kullota e livadhe

Kjo leje eshte e vlefshme deri me 10.10.2008




SEKRETARI

Emilja Bibolli



KRYETARI

Kolë MALAJ



REPUBLIKË E SHQIPËRIE / REPUBLIC OF ALBANIA




ARZEN
Name
ARBEN
Surname
ALB
Nationality
21 FEB/SHKUT 1960
Date of Birth
MRP
Date of Expiry
06 DEC/DEJTE 2004

100 CM
Height
KAFI
By the Holder of the Card
TIRANE
Issued in
11015190500611
Date of Issuance
05 DEC/DEJTE 2014
Date of Expiry

ALBETTO KARBENI
1101519050061178

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR. /

Taksa e pulles e paguar



DEKLARATE

Sot ne date 09.03.2007 (dymije e shtate) para meje Noteres Lindita Kokona, anetare e Dhomes se Notereve Tirane, me zyre ne Bulevardin "Gjergj Fishta", u paraqit personalisht :

AV.KETRIN TOPÇIU, e bija e Xhaferrit, lindur ne Tirane ne 12.11.1968, banuese ne Tirane, madhore, me zotesi te plote juridike per te vepruar, e njohur personalisht prej meje, e cila ne baze te nenit 40 te Ligjit "Per Shoqerite Tregtare" depozitoi shumen prej 100.000(njeqind mije) lek, prane zyres se noterise, ne lidhje me rregjistrimin e shoqerise " Insituti i Studimeve dhe Projektimeve Pyjore (ISPP) " Shpk, me cilesine e perfaqesueses me Prokuren e Posacme Nr.699 rep. Nr.78 kol. date 05.03.2007, te Z.Arben PETTO, Administrator dhe Ortak i Vetem i Shoqerise "ISPP" Shpk.

NOTERE
LINDITA KOKONA

- për punime në kullota, livadhe dhe ndërtimin e merementimin e veprave për sigurimin e ujit të pijshëm në kullota e livadhe

NE FUSHEN E NDERTIMEVE :

- Gërmime dhe me punime eventuale murature e betonarme – prishje dhe punime në tokë të gërmuar.
- Prodhim materiale inerte – gurë.
- Prodhim elemente betoni e betonarme të zakonshëm – 2. paranderur – 3. gurë dekorativë – mermer.
- Ndërtime civile – industriale – turistike – bujqësore deri në 5 kate.
- Ndërtime civile – industriale – turistike – bujqësore mbi 5 kate – Rikonstruksione.
- Ndërtim banese me skelet mbi 8 kate.
- Ndërtim rruge kategoria IV dhe V.
- Ndërtim rruge kategoria III dhe II.
- Punime të mirëmbajtjes dhe sinjalizimit në rrugë, ndërtim mbishtresa rrugore.
- Ndërtim ura dhe vepra arti deri në 10 m.
- Ndërtime portuale – bankina – basene – pontile.
- Ndërtim ujësjellës – kanalizime –kanale e impiante vaditjeje.
- Ndërtim diga – damba deri 10 m.
- Sillose, kufla, kulla uji etj., prej betonarme- metalike.
- Përforcime themeli e punime nëntokësore.
- Izolime mbi dhe nëntokësore nga ujërat.
- Themele të veçanta.
- Punime karpenterie druri.
- Punime karpenterie metali.
- Instalim i impianteve higjienike, kuzhina, lavanteri, hidrosanitare-mirembajtja e tyre
- Instalim i materialeve prej druri-metalike plastike-xhami.
- Punime bojatisje – hidroizolimi – termoizolimi – akustikë – kundra zjarrit.

Shoqëria ka formën ligjore të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar.

Emertimi i plote i shoqërisë është "Instituti i Studimeve dhe Projektive Pyjore".
Emertimi i shkurtuar është "**ISPP**" **Sh.p.k.**

Selia e Shoqërisë është në adresën: Rruga "Myslym Shyri", Pallati 6, Ap 35, Tirane, Shqipëri.

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj për një periudhë kohore të papercaktuar.

Kapitali themelues i shoqërisë "**Instituti i Studimeve dhe Projektive Pyjore**" **Sh.p.k** Sh.p.k është 100 000 (njëqind mijë) Leke, i ndarë në 100 pjesë me vlerë nominale prej 1.000 (një mijë) leke secila.

Shoqeria do te administrohet nga nje Administrator i Vetem.
Administrator i pare i shoqerise eshte Z. Arben Petto, person me shtetesi shqiptare, i datelindjes 21/2/1960, me adrese banimi Rruga "Abdyl Frasher", Tirane, Shqiperi. Mbajtes i Pasaportes me Nr Z 0116878.

Bazuar në sa më sipër si dhe në perputhje me Ligjin Nr. 7638, 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare", dhe Ligjin Nr. 7667, datë 28.01.1993, "Për Regjistrin Tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare", parashtrij këtë kërkesë për regjistrimin si person juridik në Regjistrin Tregtar të shoqërisë " ISPP" Sh.p.k.

Lutemi gjeni bashkengjitur dokumentacionin e nevojshem.

KERKUESI

Per shoqerine

"Instituti i Studimeve dhe Projektmeve Pyjore" Sh.p.k

ADMINISTRATORI
Arben Petto



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR. 700 REP.
NR. — KOL.

PULLE TAKSE



VERTETIM

Ne Tirane, sot ne date 05.03.2007 (dymije e shtate) para meje Noteres Lindita KOKONA, anetare e Dhomes se Notereve Tirane, me zyre ne Bulevardin "Gjergj Fishta", u paraqit personalisht:

Z.ARBEN PETTO, datelindja 21.02.1960, banues ne Tirane Rruga "Abdyl Frasheri", me cilesine e Administratorit dhe Ortak i Vetem i Shoqerise "Instituti i Studimeve dhe Projektimeve Pyjore", i cili me vullnetin e tij te lire dhe te plote nenshkroi para meje Kerkesen drejtuar Gjykates se rrethit Gjyqesor Tirane dhe une noterja vertetoj sipas ligjit nenshkrimin e tij.

Baza Ligjore : Ligji "Per Noterine".

**NOTER
LINDITA KOKONA**